

OPERATORI I SISTEMIT, TRANSMISIONIT DHE TREGUT - KOSTT SH.A.

Raporti I Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

PËRMBAJTJA	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	2
PASQYRA E POZICIONIT TË KOMPANISË	3
PASQYRA E TË HYRAVE GJITHPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE EKUITET	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	6
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE	7 - 27

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për bordin e drejtorëve të KOSTT SH.A.

Ne kemi qenë të angazhuar për auditimin e pasqyrave financiare shoqëruese të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut , Sistemit “KOSTT SH.A.” (më tej referuar si “Kompania”), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2011, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare që janë të liruara nga gabimet materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit dhe bërjen e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në kryerjen e auditimit. Për shkak të çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për kualifikim të opinionit, ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe planifikojmë e kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga ndonjë gabim material.

Auditimi përfshinë procedurat e kryerjes për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen në gjykimin e auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë mashtrim ose gabim. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të riskut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të Kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga Menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të Kompanisë paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2011 dhe performansën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

BDO Kosova L.L.C.

BDO Kosova L.L.C
Prishtina, Kosova
19 Mars 2012

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.
Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2011

	Shënim	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
ASETET			
Asetet afatgjata			
Prona dhe pajisjet	4	94,102	88,791
Asetet e paprekshme	5	1,457	36
		95,559	88,827
Asetet afatshkurtra			
Stoqet	6	1,654	908
Të arkëtueshmet	7	7,590	9,281
Kërkesa tjera	8	3,191	6,996
Paraja në dorë dhe në bankë	9	18,605	14,850
		31,040	32,035
TOTAL ASETET		126,599	120,862
EKUITETI DHE OBLIGIMET			
Ekuiteti			
Kapitali i pronarëve	10	25	25
Primi i aksioneve	11	28,347	28,347
Fitimet e mbajtura		14,085	10,617
Fitimi i vitit		1,283	3,468
		43,740	42,457
Obligimet afatgjata			
Grantet e shtyra	12	75,414	69,392
Obligimet afatshkurtra			
Obligimet tregtare dhe të tjera	13	7,445	9,013
		82,859	78,405
TOTAL EKUITETI DHE OBLIGIMET		126,599	120,862

Autorizuar nga menaxhmenti për botim dhe nënshkruar më 19 Mars 2012.

Ztr. Fadil Ismajli

Ztr. Nebih Haziri


Kryeshef Ekzekutiv


Zyrtari Kryesor Financiar

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.

Pasqyra e të Hyrave Gjithëpërfshirëse për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

	Shënim	Për fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Të hyrat operative			
Transmisioni i energjisë	14	14,706	20,076
Të hyrat tjera operative	15	3,543	2,348
		18,249	22,424
Minus: Shpenzimet operative			
Shpenzimet e Stafit	16	(2,945)	(2,736)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4-5	(6,349)	(4,866)
Riparimet dhe mirëmbajtja	17	(744)	(752)
Humbjet në transmision të energjisë		(3,579)	(4,319)
Shpenzimet tjera operative	18	(1,333)	(1,514)
Rregullimi sekondar		-	(1,600)
Provizioni për të arkëtueshmet	7	(2,390)	(2,765)
Provizioni për dëmtim të inventarit		(23)	(32)
Fitimi Operativ		886	3,840
Të hyrat e Interesit		543	301
Fitimi para tatimit		1,429	4,141
Shpenzimet e tatimit	19	(146)	(673)
FITIMI NETO PËR VITIN		1,283	3,468
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
TOTALI I TË HYRAVE GJITHPËRFSHIRËSE PËR VITIN		1,283	3,468

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.
 Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Fitimet e mbajtura	TOTALI
	(in EUR 000)			
Bilanci më 1 Janar 2010	25	28,347	10,617	38,989
Neto fitimi për vitin	-	-	3,468	3,468
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2010	25	28,347	14,085	42,457
Bilanci më 1 Janar 2011	25	28,347	14,085	42,457
Neto fitimi për vitin	-	-	1,283	1,283
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2011	25	28,347	15,368	43,740

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave
 financiare.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.
Pasqyra e të Rrjedhës së Parasë për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

	Shënim	Për fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Rrjedha e parasë nga aktivitet operative			
Fitimi para tatimit		1,429	4,141
Korrigjuar për:			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	4-5	6,349	4,866
Të hyrat nga interesi	15	(543)	(301)
Neto shlyerjet e aseteve fikse	4	2	8
Provizioni për dëmtim të inventarit	6	23	32
Provizioni për të arkëtueshmet	7	2,390	2,765
Të hyrat shtyra nga grantet	12	(3,276)	(1,828)
Shpenzimi i tatimit në fitim	19	194	657
Suficiti operativ para ndryshimeve në asete dhe obligime		6,568	10,340
(Rritja)/zvogëlimi në inventar		(560)	76
Rritja në të arkëtueshmet		(973)	(2,245)
Zvogëlimi në kërkesa tjera		3,805	1,615
(Zvogëlimi)/rritja në të pagueshmet dhe obligime tjera		(1,649)	748
Paraja e gjeneruar në operacione		7,191	10,534
Tatimi në fitim i paguar		(194)	(500)
Neto paraja e gjeneruar në operacione		6,997	10,034
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive			
Interesi i pranuar		543	301
Blerjet e aseteve fikse	4	(11,617)	(18,473)
Blerja e aseteve të paprekshme	5	(1,466)	(7)
Neto paraja e përdorur në aktivitet investive		(12,540)	(18,179)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Grantet e pranuar		9,298	14,019
Grantet e kthyer (të papërdorura)		-	(161)
Neto paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		9,298	13,858
Neto rritja e parasë dhe ekuivalenteve të parasë		3,755	5,713
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		14,850	9,137
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	9	18,605	14,850

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1 TË PËRGJITHSHME

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe tregut (këtej e tutje "Kompania" ose "KOSTT Sh.a.") u krijua si entitet i pavarur me 23 Dhjetor 2005 nga transformimi i "Korporatës Energjetike të Kosovës ("KEK") dhe u regjistrua si një Kompani aksionare sipas rregullores së UNMIK Nr. 2001/6, date 8 Shkurt 2001 mbi Organizatat e Biznesit ("Rregullorja") me numër regjistrimi të biznesit 70325350.

Kompania nisi veprimtarinë e saj të pavarur në 1 Korrik 2006 sipas marrëveshjes midis KEK Sh.a. dhe KOSTT Sh.a. lidhur me marrëdhënien kalimtare, tregtare dhe operacionale midis KEK SH.A. dhe KOSTT SH.A. mbi transferimin e përgjegjësisë mbi operacionet dhe mirëmbajtjen e Rrjetit të Transmisionit të KOSTT SH.A..

Adresa e regjistruar e Kompanisë është "Ndërtesa e shpërndarjes dhe transmisionit, Iljaz Kodra, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës".

Kompania zotërohet plotësisht nga Grupi i operatorit të sistemit, transmisionit dhe tregut SH.A. Kosova.

Ne përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 date 13 Qershor, 2008 "Ligji mbi ndërmarrjet publike", Operatori i Sistemit, transmisionit dhe tregut SH.A. është i zotëruar nga Republika e Kosovës.

Aktivitetet kryesore të Kompanisë janë menaxhimi dhe shfrytëzimi i sistemit të transmetimit të elektricitetit të Kosovës dhe merr përsipër transmisionin e elektricitetit në rrjetet e elektricitetit kryesore me voltazh të lartë. Si një operator tregu, Kompania ka përgjegjësi gjithashtu për organizimin dhe administrimin e tregtimit të elektricitetit dhe menaxhon procesin e marrëveshjeve të tilla.

Pasqyrat financiare janë të prezantuar në Euro valutë funksionale e Shoqërisë dhe valutë e prezantimi.

2 ADOPTIMI I STANDARDEVE TE REJA DHE TE RISHIKUARA

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive prej 1 Janarit 2011

Ndryshimet e mëposhtme te standardeve ekzistuese te lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare te Kontabilitetit dhe interpretimet e lëshuara nga Komiteti për interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar janë efektive për periudhën e tanishme:

Ndryshimet në SNK 24, Shpalosja e Palëve të Ndërlidhura (e lëshuar në Nëntor 2009 dhe efektive për periudhat që fillojnë më apo pas Janarit 2011). SNK 24 është rishikuar në 2009 për: (a) thjeshtëzimin e definicionit të palës së ndërlidhur, qartësimi i kuptimit të menduar dhe eliminimin e jo-konsistencës; dhe për (b) të ofruar përjashtim të pjesshëm për kërkesat për shpalosjen e entitete të lidhura me qeveritë. Si rezultat i standardit të rishikuar, Kompania tani gjithashtu shpalos dhe zotimet e kontraktuara për të blerë dhe shitur mallra dhe shërbime palëve të saja të ndërlidhura.

Përmirësimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (lëshuar në Maj 2010 dhe efektive nga 1 Janari 2011) Këto përmirësime përbëhen prej një përzierje të ndryshimeve thelbësore dhe sqarimeve në standardet dhe interpretimet në vijim: SNRF 1 është ndryshuar (i) që të lejojë vlerën e bartur të GAAP të shfrytëzohet si kosto e konsideruar e një gjëje të pasuri, impiant dhe pajisje apo një aset të paprekshëm nëse ajo gjë është përdorur në operacione të rregullimit të normës, (ii) që të lejojë që rivlerësimi i shtyrë nga ndonjë ndodhi të përdoret si kosto e konsideruar e pasurisë, impianteve dhe pajisjeve edhe nëse rivlerësimi paraqitet gjatë një periudhe të mbuluar nga pasqyrat e para me SNRF si dhe (iii) të kërkojë adoptues që ti shpjegojë ndryshimet në politikat e kontabilitetit ose në përjashtimet e SNRF 1 ndërmjet raportit interim të parë me SNRF dhe pasqyrave të para financiare me SNRF, SNRF 3 është ndryshuar (i) të kërkojë matje në vlerën e saktë (përveç nëse ndonjë bazë tjetër për matje kërkohet nga ndonjë standard tjetër i SNRF) të interesave jo kontrolluese të cilat nuk janë interesa momentale pronësore apo nuk emërojnë mbajtësin me pjesë proporcionale të aseteve neto në rast të likuidimit, (ii) të ofrojë udhëzim për marrëveshjet e bazuara në aksione të blerësit e pagesës që nuk janë zëvendësuar, apo vullnetarisht janë zëvendësuar si rezultat i kombinimit të biznesit si dhe (iii) që të qartësojë se kontingjentet nga kombinimet e biznesit të cilat janë paraqitur para datës efektive të SNRF 3 të rishikuar (lëshuar në Janar 2008) do të llogariten në përputhje me udhëzimet e versioneve të mëparshme të SNRF 3; SNRF 7 është ndryshuar që të qartësojë disa kërkesa të shpalosjeve, në veçanti (i) duke shtuar theksim eksplisit në bashkëveprimin e shpalosjeve kualitative dhe kuantitative për natyrën dhe shtrirjen e rreziqeve financiare, (ii) duke hjekur kërkesën për të shpalosur vlerën bartëse të aseteve financiare të re negociuara të cilat përndryshe do ju kalojë afati apo do të zhvlerësohen, (iii) duke zëvendësuar kërkesën për shpalosje të vlerës së drejtë të kolateralit ma një kërkesë më të përgjithshme për të shpalosur efektin financiar të tij, si dhe (iv) duke qartësuar se një entitet duhet të shpalos shumën e kolateralit të përjashtuar të mbajtur në datën e raportimit, dhe jo shumën e fituar gjatë periudhës raportuese; SNK 1 është ndryshuar që të qartësojë kërkesat e prezantimit dhe përbërjen e pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet (ky ndryshim është adoptuar nga Kompania në pasqyrat e viteve të kaluara)

2 ADOPTIMI I STANDARDEVE TE REJA DHE TE RISHIKUARA (VAZHDIM)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive prej 1 Janarit 2011 (Vazhdim)

SNK 27 është ndryshuar duke qartësuar rregullat e tranzicionit për ndryshimet në SNK 21, 28 dhe 31 të bëra nga SNK 27 i rishikuar (siç është ndryshuar në Janar 2008); IAS 34 është ndryshuar që të shtojë shembuj të ngjarjeve të rëndësishme dhe transaksione që kërkojnë shpalosje në raportin e kondensuar interim, duke përfshirë transferet në mes niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë, ndryshimet në klasifikimin e aseteve financiare apo ndryshimet në mjediset e biznesit apo ekonomike të cilat afektojnë vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të entitetit.; dhe KIRF 13 është ndryshuar që të qartësojë matjen e vlerës së drejtë të kredisë. Ndryshimet e mësipërme kanë rezultuar në shpalosje shtesë apo të rishikuara, mirëpo nuk kanë pasur ndikim material në matjen apo njohjen e transaksioneve dhe balancave të raportuara në këto pasqyra financiare. Efekti financiar i kolateralit të nevojshëm për tu shpalosur nga ndryshimet e SNRF 7 është paraqitur në këto pasqyra financiare duke shpalosur vlerat e kolateralit veçmas për (i) ato asete financiare ku kolaterali është i barabartë me, apo e kalon, vlerën bartëse të asetit dhe (ii) ato asete financiare ku kolaterali është më i vogël se vlera bartëse e asetit.

Standardet dhe interpretimet tjera efektive për këtë periudhë. KIRF 19 'Shlyerja e detyrimeve financiare me instrumente të ekuitetit', ndryshimet në SNK 32 në klasifikimin e çështjeve të të drejtave, qartësimi në KIRF 14 "SNK 19 - Kufizimi I definimit të një asemi përfitimi, Kërkesat minimale të financimit dhe bashkëveprimi i tyre' që kanë të bëjnë me parapagimet dhe ndryshimet në SNRF 1 'Adoptimi për herë të parë i SNRF', nuk kanë pasur ndikim në këto pasqyra financiare.

Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka shtyre në asnjë ndryshim në politikat e kontabilitetit të Kompanisë.

2.2 Standardet dhe interpretimet e lëshuara por që Kompania nuk i ka adoptuar

SNRF 9, Instrumentet Financiare Pjesa 1: Klasifikimi dhe Matja. SNRF 9 i lëshuar në Nëntor 2009, i zëvendëson ato pjesë të SNK 39 që kanë të bëjnë me klasifikimin dhe matjen e aseteve financiare. SNRF 9 më tej është ndryshuar në Tetor 2010 që të adresojë klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare dhe në Dhjetor 2011 për të (i) ndryshuar datën efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2015 dhe (ii) të shtojë shpalosje të tranzicionit. Karakteristikat kryesore të standardit janë si në fillim:

- Asetet financiare kërkohet që të klasifikohen në dy kategori matjesh: ato që duhet të maten më pas në vlerë të saktë, dhe ato që maten më pas në koston e amortizuar. Vendimi duhet marrë në njohjen fillestare. Klasifikimi varet nga modeli i biznesit të entitetit për të menaxhuar instrumentet financiare dhe karakteristikat e rrjedhës së parasë të instrumentit
- Një instrument matet më pas në koston e amortizuar vetëm nëse është instrument borxhi dhe (i) qëllimi i modelit të biznesit të entitetit është që të mbajë asetin që të grumbullojë rrjedhën e kontraktuar të parasë, dhe (ii) rrjedha e kontraktuar e parasë së asetit paraqet vetëm pagesat e kryegjësë dhe interesit (kjo është 'karakteristikat themelore të borxhit'). Të gjitha instrumentet e tjera të borxheve duhet të maten me vlerë e saktë nëpërmjet fitimit apo humbjes.

2 ADOPTIMI I STANDARDEVE TE REJA DHE TE RISHIKUARA (VAZHDIM)

2.2 Standardet dhe interpretimet e lëshuara por që Kompania nuk i ka adoptuar (Vazhdim)

- Të gjitha instrumentet e ekuitetit duhet të maten më pas në vlerën e saktë. Instrumentet e ekuitetit të cilat mbahen për tregti do të maten në vlerën e saktë nëpërmjet fitimit apo humbjes. Për të gjitha investimet tjera të ekuitetit, mund që në njohjen fillestare të bëhet zgjidhje e pakthyeshme, që të njihen fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të perealizuara nëpërmjet të hyrave tjera gjithëpërfshirëse në vend se me fitim apo humbje. Nuk duhet të bëhet riciklim i fitimit apo humbjes me vlerë të drejtë në fitim apo humbje. Kjo zgjedhje mund të bëhet për çdo instrument veç e veç. Dividendët duhet të paraqiten në fitim apo humbje, përderisa paraqesin kthim në investim.
- Shumica e kërkesave në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë bartur të pandryshuara në SNRF 9. Ndryshimi kryesor është se entiteti duhet të paraqes efektet e ndryshimit në reskun kreditor të detyrimeve financiare të caktuar në vlerën e saktë nëpërmjet fitimit apo humbjes në të hyrat tjera gjithëpërfshirëse. Edhe pse adoptimi i IFRS 9 është i detyrueshëm nga 1 Janari 2015, adoptim më i hershëm është i lejuar.

SNRF 10, Pasqyrat financiare të konsoliduar (lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013), zëvendëson të gjithë udhëzimin në kontroll dhe konsolidim në SNK 27 'Pasqyrat financiare të konsoliduar dhe të veçanta' dhe SIC 12 'Konsolidimi - entitetet me qëllim të veçantë'. SNRF 10 e ndryshon definicionin e kontrollit ashtu që kriteret e njëjta aplikohen në të gjitha entitetet që të përcaktohet kontrolli. Ky definicion mbështetet me udhëzim të gjerë të aplikimit.

SNRF 11, Marrëveshjet e përbashkëta, (lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013), zëvendëson SNK 31 'Interesat në Marrëveshjet e Përbashkëta' dhe SIC-13 'Entitetet e kontrolluara në mënyrë të përbashkët - Kontributet jo monetare nga ana e sipërmarrjeve'. Ndryshimet në definicione kanë reduktuar numrin e llojeve të marrëveshjeve të përbashkëta në dy: Operacionet e përbashkëta dhe Sipërmarrjet e përbashkëta. Politika ekzistuese e konsolidimit proporcional për entitetet e kontrolluara në mënyrë të përbashkët është eliminuar. Kontabiliteti i ekuitetit është i detyrueshëm për pjesëmarrësit në sipërmarrjet e përbashkëta.

SNRF 12, Shpalosja e Interesat në Entitetet tjera, (lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2013), aplikohet tek entitetet të cilat kanë interes në ndonjë degë, marrëveshja të përbashkët, bashkëpunëtor ose në ndonjë entitet me strukturë të pa konsoliduar. Zëvendëson kërkesat e shpalosjes që për momentin mund të gjenden tek SNK 28 'Investime në pjesëmarrje'. SNRF 12 kërkon nga entitetet që të shpalosin informata të cilat ndihmojnë lexuesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë natyrën, rreziqet dhe efektet financiare lidhur me interesin e entitetit në degë, pjesëmarrje, marrëveshje të përbashkëta dhe entitete me strukturë të pa konsoliduar. Për të arritur këto qëllime, standardi ri kërkon shpalosje në një numër fushash, duke përfshirë gjykime dhe supozime të rëndësishme të bëra për të përcaktuar se një entitet kontrollon, bashkërisht kontrollon, apo ndikon në mënyrë të konsiderueshme në interesat e entiteteve tjera, shpalosje të zgjeruara në aksionet e interesave që nuk i kontrollon në aktivitetet grupore dhe rrjedhën e parasë, informacionin financiar të përmbledhur të degëve me interes jo kontrollues material, dhe shpalosje e detajuar e interesave në entitetet me strukturë jo të konsoliduar.

2 ADOPTIMI I STANDARDEVE TE REJA DHE TE RISHIKUARA (VAZHDIM)

2.2 Standardet dhe interpretimet e lëshuara por që Kompania nuk i ka adoptuar (Vazhdim)

SNRF 13, Matja e drejtë e vlerës, (lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013), ka për qëllim përmirësimin e konsistencës dhe reduktimin e kompleksitetit duke siguruar përcaktimin e rishikuar të vlerës së drejtë, dhe një burim të vetëm të matjes së drejtë të vlerës dhe shpalosjen e nevojave për përdorimin e SNRF-ve.

SNK 27, Pasqyrat financiare të ndara, (rishikuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013), ishte ndryshuar dhe tani qëllimi i tij është që të parashkruaj kontabilitetin dhe shpalos kërkesat për investime në degë, sipërmarrje të bashkuara dhe shoqata kur një entitet përgatit pasqyra financiare të ndara. Udhëzimi mbi kontrollin dhe pasqyrat financiare të konsoliduar ishte zëvendësuar nga SNRF 10, Pasqyrat financiare të konsoliduar.

SNK 28, Investimet në shoqata dhe sipërmarrjet e bashkuara, (rishikuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013). Ndryshimi i SNK 28 ka rezultuar nga projekti i Bordit mbi sipërmarrjet e përbashkëta. Gjatë diskutimit të atij projekti, Bordi kishte vendosur ta inkorporoj kontabilitetin për sipërmarrjet e bashkuara duke përdorur metodën e ekuitetit në SNK 28 sepse kjo metodë është e aplikueshme për të dyja sipërmarrjet e bashkuara dhe shoqatat. Përveç këtij ndryshimi, pjesa tjetër e udhëzimit ka mbetur e pandryshuar.

Shpalosjet - Transferet e asetëve financiare - Ndryshimi 7 SNRF (lëshuar në Tetor 2010 dhe efektive për periudhat që fillojnë më apo pas 1 Korrik 2011). Ndryshimi kërkon shpalosje shtesë duke respektuar rritjen e ekspozimit ndaj rrezikut të asetëve financiare të transferuara. Ndryshimi përfshin nevojën për shpalosjen e klasës së asetit, natyrën, vlerën bartëse dhe një përshkrim të rreziqeve dhe shpërblimeve të asetëve financiare të transferuara tek një palë tjetër, ende mbetet në bilancin e entitetit. Shpalosjet janë po ashtu të nevojshme që t'i mundësojnë përdoruesit për të kuptuar shumën e çfarëdo detyrimi të lidhur, dhe lidhjen në mes të asetëve financiare dhe detyrimeve të lidhura. Ku asetet financiare nuk janë njohur, por entiteti është ende i ekspozuar ndaj rreziqeve dhe shpërblimeve lidhur me asetin e transferuar, shpalosje shtesë është e nevojshme për t'u kuptuar efektet e këtyre rreziqeve.

Ndryshimet në SNK 1, Prezantimi i Pasqyrave Financiare (lëshuar në Qershor 2011, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Korrikut 2012), ndryshon shpalosjen e artikujve të prezantuar në të hyrat tjera gjithëpërfshirëse. Ndryshimet kërkojnë nga entitetet që të ndajnë artikujt në të hyrat tjera të gjithëpërfshirëse në dy grupe, duke u bazuar se a duhet apo jo të riklasifikohej në fitimin apo humbjen në të ardhmen. Titulli i sugjeruar i shfrytëzuar nga SNK 1 është ndryshuar në 'pasqyra e fitimit dhe humbjes dhe të hyrat tjera gjithëpërfshirëse'. Grupi pret që standardi i ndryshuar të ndryshojë prezantimin e pasqyrave financiare të tija, por nuk ka ndikim në matjen e transaksioneve dhe balancave.

SNK 19 i ndryshuar, Përfitimet e të punësuarve (lëshuar në Qershor 2011, efektive për periudhat që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013), ka ndryshime të rëndësishme në njohjen dhe matjen përfitimeve të definuar të shpenzimeve të pensionit dhe ndërprerjes së kontratës, dhe në shpalosjen e të gjitha përfitimeve të të punësuarve. Standardi kërkon njohjen e të gjitha ndryshimeve në përfitimet neto të detyrimeve (aseteve) të përfitimeve kur paraqiten, si në vijim: (i) kosto e shërbimeve dhe interesat neto në fitim apo humbje; dhe (ii) ri matjet në të hyrat tjera gjithëpërfshirëse.

2 ADOPTIMI I STANDARDEVE TE REJA DHE TE RISHIKUARA (VAZHDIM)

2.2 Standardet dhe interpretimet e lëshuara por që Kompania nuk i ka adoptuar (Vazhdim)

Shpalosjet - Thyerja e Aseteve dhe Detyrimeve Financiare - Ndryshimet në SNRF 7 (lëshuar në Dhjetor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2013). Ky ndryshim kërkon shpalosje të cilat do ti mundësojnë shfrytëzuesve të pasqyrave financiare të entiteteve të vlerësojnë efektin apo efektin potencial të thyerjes së marrëveshjeve, duke përfshirë të drejtën për thyerje. Ndryshimi do të ketë ndikim në shpalosje mirëpo nuk do të ketë efekt në matjen dhe njohjen e instrumenteve financiare.

Thyerja e Aseteve dhe Detyrimeve Financiare - Ndryshimet në SNK 32 (lëshuar në Dhjetor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janarit 2014). Ky ndryshim ka shtuar udhëzim të aplikacionit për SNK32 që të adresojë jo vazhdueshmërinë e identifikuar në aplikimin e disa kriterëve të thyerjes. Kjo përfshin qartësimin e kuptimit të 'momentalisht ka të drejtë ligjore për thyerje' dhe se disa sisteme të shlyerjeve bruto mund të konsiderohen ekuivalente me shlyerjet neto.

Standardet dhe interpretimet tjera të rishikuara: Ndryshimet në SNRF 1 'Adoptimi për herë të parë i SNRF', në lidhje me hiperinflacionin e ashpër dhe eliminimin e referencave të datave të caktuara për disa përjashtime, nuk do të ketë ndikim në këto pasqyra financiare. Ndryshimi në SNK 12 'Tatimet mbi të ardhurat', të cilat prezantojnë një gjykim kundërshtues se një pasuri investuese e bartur në vlerën e drejtë është e mbuluar në tërësi nga shitjet, nuk do të ketë ndikim në këto pasqyra financiare. KIRF 20, Kostot e nxjerra në fazën e prodhimit të sipërfaqes së një miniere, konsideron kur dhe si të llogariten për dobitë që dalin nga nxjerrja e aktivitetit nga industria e minierave. Kompania ka zgjedhur të mos adoptoj këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës efektive të tyre. Kompania parashikon se adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të kenë efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar. Kompania konsideron ndikimin e SNRF 9 dhe datën e aplikimit fillestar të tij.

3 POLITIKAT E RENDËSISHME TË KONTABILITETIT

3.1 Deklaratë e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur ne përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar ne koston historike, përveç rivlerësime të disa asetëve fikse.

3.3 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet ne monedha të huaja konvertohen ne monedhën funksionale me kursin e datës se transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare ne monedha ne datën e raportimit të huaja konvertohen ne monedhën funksionale me kursin e datës se raportimit, përveç atëherë kur kompania ka kontratë për fiksime të kurseve .

Fitimet apo humbjet e shkaktuar nga këto transaksione regjistrohen në fitim apo humbje të periudhës.

3 POLITIKAT E RENDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.4 Kostoja e huazimeve

Kostoja e huazimit atribuohet drejtpërdrejt blerjeve, ndërtimit apo prodhimit të aseteve që kualifikohen, asetet të cilat kërkojnë një kohë të gjatë të arrijnë të jenë funksionale për qëllimin të cilin përdoren, i shtohen kostos së asetit, deri në kohën kur asetet e këtilla janë gati për përdorim apo shitje. Të hyrat nga investimet të cilat fitohen nga investimet e përkohshme janë të zvogëluara nga kostoja e huazimeve të cilat kapitalizohen.

Të gjitha kostot tjera të huazimeve regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën të cilën edhe ndodhin.

3.5 Grantet Qeveritare

Grantet qeveritare nuk njihen derisa të ekzistojë siguri e arsyeshme që Kompania do të respektojë kushtet e këtyre granteve dhe që ato grante do të pranohen.

Grantet qeveritare kushti kryesor i të cilave është që Kompania duhet të blejë, ndërtojë ose në ndonjë mënyrë tjetër të sigurojë asete jo-rrjedhëse njihen si të hyra të shtyra në bilancin e gjendjes dhe transferohen në pasqyrën e të ardhurave në bazë sistematike dhe racional përgjatë kohës së përdorimit të aseteve përkatëse.

Grantet tjera qeveritare njihen si e hyrë gjatë periudhave të nevojshme për t'i barazuar ato me shpenzimet të cilat ato kanë për qëllim t'i kompensojnë, në mënyrë sistematike. Grantet qeveritare që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet apo humbjet që tani kanë ndodhur apo që kanë për qëllim dhënien e përkrahjes së menjëhershme financiare për Kompaninë pa shpenzime që lidhen me të ardhmen njihen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

3.6 Kostot e përfitimeve të pensionimit

Kompania nuk bënë provizionin dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve përveç atyre të paguara pranë Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), referojuni edhe notës 25 gjithashtu.

3.7 Të pagueshmet tregtare dhe te tjera

Obligimet tregtare dhe të tjera janë të vlerësuara në kosto e cila është vlera reale e obligimit që duhet të paguhet në të ardhmen për mallra dhe shërbime të pranuar pa marr parasysh a është faturuar Kompanisë apo jo.

3 POLITIKAT E RENDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.8 Tatimet

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe tatimin e shtyre.

Tatimi në të ardhura

Tatimet e pagueshme janë të bazuar në fitimet e vitit në bazë të Ligjit Nr. 03/L- 162 mbi Tatimin në Korporatat. Fitimet e tatueshme dallojnë nga tatimi i raportuar në pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse për arsye se i përjashton zërat e të hyrave dhe shpenzimeve të cilat janë të tatueshme apo të përjashtuara në vitet tjera dhe tërësisht përjashton zërat të cilat nuk pranohen asnjëherë. Obligimet e Kompanisë për tatimin e vitit kalkulohen në bazë të shkallës së tatimit 10%. Sipas legjislacionit të tanishëm humbjet tatimore mundë të barten për shtat vjet pas vitit të cilin humbja është shkaktuar.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet, duke marrë në konsiderate diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të asetëve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të jenë të zbatueshme ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi në datën e raportimit. Asetet e këtilla apo obligimet në diferencat e përkohshme nuk njihen nëse vijnë nga Emri i Mirë (goodwill) apo nga njohja fillestare e (të tjera nga kombinimi i bizneseve) të asetëve dhe obligimeve tjera në efektet e translacioneve të cilat nuk kanë efekt në fitimin e tatueshëm apo fitimin e kontabilitetit.

Vlera e asetit tatimor rishikohet çdo vjet në datën e bilancit dhe zvogëlohet në vlerë e cila nuk është e mundur të realizohet fitimet e tatueshme që këto asetet te kthehen.

Matja e asetit apo obligimit tatimor të shtyrë reflekton pasojat e tatimeve të cilat do të pasojnë nga metoda të cilën Kompania pret, më datën e raportimit, te thyej apo kthejë vlerën e asetit apo obligimit.

Asetet dhe detyrimet e shtyra tatimore thyhen në mes tyre nëse ekziston një e drejte e rregulluar me ligj për tu thyer detyrimet dhe aktivet tatimore të periudhës, dhe kur ato lidhen me tatime që vendosen nga i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtin subjekt tatimor.

Tatimi i vitit apo i shtyrë njihen si fitim apo shpenzim, përveç kur ato kanë të bëjnë me zërat të cilat janë kredituar apo debituar në ekuitet, në këtë rast tatimi njihet direkt në ekuitet, apo aty ku njihen së pari nga kontabilizimi fillestar i kombinimit të biznesit.

3 POLITIKAT E RENDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.9 Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, impiantet dhe pajisjet të blera para 30 Qershorit 2006, data efektive e transformimit, ku janë transferuar në Kompani në vlerë e librave të tyre.

Toka dhe objektet të mbajtura në përdorim për ofrim të shërbimeve, janë të cekura në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën e tyre të rivlerësuar, duke qenë vlera reale në datën e rivlerësimit, minus çdo zhvlerësim i akumuluar dhe humbjet nga dëmtimet. Rivlerësimet bëhen me rregullsi të mjaftueshme ashtu që vlerat e mbetura nuk dallojnë materialisht nga ato që do të përdreshin në datën e bilancit.

Çdo rritje e rivlerësimit që vjen nga rivlerësimi të tokës apo objekteve kreditohet ne ekuitet tek rezerva e revalorizimit, përveç në vlerën që ai shfuqizon një rënie nga rivlerësimi për aktivin e njëjtë të njohur më parë në fitim ose humbje, në rastet e këtilla rritja kreditohet në fitim apo humbje në vlerën e mëhershme të ngarkuar. Zvogëlimi i vlerës nga rivlerësimi në tokë apo objektet e këtilla ngarkohet në llogarinë e fitimit apo humbjes në vlerën e tejkaluar bilancin, nëse ka, të mbajtur në rezervën e rivalorizuar të lidhur me rivlerësimin e aseteve tjera.

Zhvlerësimi në objektet e rivlerësuar ngarkohet në fitim apo humbje. Në shitje apo shlyerjen e mëvonshme, suficiti i rivlerësimit të atribuar i mbajtur në rezervën e rivalorizuar transferohet drejtpërdrejt në fitimet e mbajtura. Asnjë transfer i rezervës së rivalorizuar në fitimet e mbajtura nuk bëhet përpos kur asetet çregjistrohet.

Pronat të cilat në ndërtim për prodhim, apo qëllime të administratës, apo për qëllime të pacaktuara, mbahen në kosto, minus ndonjë dëmtimi i njohur. Kostoja përfshin tarifën profesionale për asetin i cili kualifikohet, kostot e huazimeve kapitalizohen në pajtim me politikën e kontabilitetit të Kompanisë. Zhvlerësimi i këtyre aseteve, në baza të njëjta si asetet tjera fillon kur asetet është i gatshëm për përdorim të caktuar.

Mobilet, inventari i imët, pajisjet dhe automjetet janë të prezantuar në kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet nga dëmtimet.

Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të eliminoj kostot apo vlerësimin e asetit, ndryshe nga toka dhe prona në ndërtim, gjatë jetëgjatësisë së tyre, duke përdorur metodën drejtvizore, si në vijim:

	2011	2010
Toka, objektet dhe përmirësimet në tokë	20 - 40 vite	20 - 40 vite
Instalimet teknike, pajisjet dhe makineria	7 - 35 vite	7 - 15 vite
Automjetet e transportit	5 vite	5 vite
Mobilet e zyrës dhe pajisjet e TI	5 vite	5 vite

3 POLITIKAT E RENDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.9 Prona, impiantet dhe pajisjet (vazhdim)

Sa i përket shtesave dhe shlyerjeve gjatë vitit, zhvlerësimi ngarkohet nga muaji i blerjes deri në muajin para shlyerjeve.

Vlerat e mbetur e aseteve dhe jetëgjatësia e përdorimit të tyre rishikohen, dhe përshtaten nëse është e nevojshme, në secilën datë të bilancit të gjendjes, me efektin e çdo ndryshimi në vlerësimet dhe e llogaritur në bazë të duhur.

Fitimet dhe humbjet nga heqja përcaktohen duke krahasuar shumën e lëvizjes me vlerën bartëse. Këto shuma përfshihen në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme ashtu siç ndodhin.

Vlera pasuese përfshihet në vlerën e asetit apo si aset i veçantë, si është e duhur, vetëm atëherë kur është e mundshëm që përfitimet e ndërlidhura do të rrjedhin tek kompania dhe kostot e ndërlidhura mund të maten besueshëm. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtja janë të ngarkuara në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare të cilat edhe ndodhen.

3.10 Shlyerja e aseteve jo-financiare

Kompania vlerëson çdo datë të bilancit nëse ka shenja se aset i përveç taksave të shtyra është dëmtuar. Nëse ekzistojnë këto shenja, vlera e këtyre aseteve rishikohen dhe vlerësohen nëse janë mbi vlerën e rikuperueshme. Nëse asetet kanë vlerë më të lart krahasuar me vlerën e rikuperueshme atëherë aset i zhvlerësohet në vlerën e tyre të rikuperueshme dhe humbja e shkaktuar njihet në pasqyrën e të ardhurave. Vlera e rikuperueshme është më e lart se vlera e asetit minus kostot e shitjes së asetit.

Atëherë kur humbja nga dëmtimet ri-kthehet, vlera e asetit është e rritur në vlerën e rishikuar, por vlera e asetit nuk e tejkalon vlerën e asetit nëse nuk do të kishë njohur humbje nga dëmtimi i asetit në vitet e mëhershme. Rikthimi i humbjes së njohur nga dëmtimi është e njohur menjëherë në pasqyrën e të ardhurave, përpos nëse aset i është duke u mbajtur në libra në vlerën e rivlerësuar, në këtë rast humbja nga dëmtimet do të trajtohet në rezervën e rivalorizuar.

Fitimet apo humbjet nga shlyerjet apo heqjet nga përdorimi i aseteve që vjen nga shitja dhe vlerës së mbajtur në kontabilitet regjistrohet ne pasqyrën e të ardhurave.

Asetet të cilat kanë jetëgjatësinë e pacaktuar nuk janë subjekt i amortizimit por testohen për dëmtim në çdo vjet.

3.11 Instrumentet financiare

Kompania çregjistron një aset financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Kompanisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur Kompania transferon të drejtën kontraktuale për të marre flukset e parasë nga aktivi financiar në një transaksion ne të cilin gjithë rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivitet financiar transferohen. Ndonjë interes ne aset financiar të transferuara qe krijohet apo mbahet nga Kompania, njihet si një aset apo detyrim i veçante.

Asetet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlere neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Kompania ka një të drejte ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qellim ose të shlyeje shumen neto, ose të realizoje aktivin dhe të shlyeje detyrimin njëkohësisht.

3 POLITIKAT E RENDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.12 Inventari, pjesë rezervë dhe mjetet tjera

Inventarët përbëhen nga pjesët e këmbimit, materialet, lëndë djegëse, pajisje dhe material të tjera.

Inventari matet me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e koston mesatare. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit duke zbritur shpenzimet përkatëse të shitjes. Materialet dhe pjesët e këmbimit njihen si shpenzime ose kapitalizohen tek aktivet afatgjata materiale, siç duhet, kur instalohen.

Artikujt në transit vlerësohen me kosto që përfshin vlerën e faturës si dhe i shtohen shpenzime të tjera të akumuluarra deri në datën e bilancit.

Provizion për lëvizje të ngadalshme dhe dëmtime të inventarit regjistrohet në pasqyrat financiare.

3.13 Kreditë, avance dhe depozitat

Këto njihen në kosto të tyre, e cila është vlera reale e tyre. Sidoqoftë një vlerësim bëhet çdo datë të bilancit që të përcaktohet nëse ka pas lëvizje në vlerën e asetit apo të grupit të asetëve. Nëse ka shenja të këtilla, vlera e vlerësuar e realizueshme e asetit të këtyllë përcaktohet dhe cilado diferencë ndërmjet vlerës së mbajtur dhe vlerës reale njihet si humbje.

3.14 Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare njihen fillimisht sipas vlerës së tyre reale dhe më pas maten sipas shumës së rikuperueshme, minus provizionet për dëmtime. Një provizion për dëmtimet në llogaritë e arkëtueshme tregtare vendoset kur ekzistojnë dëshmi objektive se Kompania nuk do të jetë në gjendje që të mbledh të gjitha shumat që ia kanë borxh sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme. Vështirësitë e theksuara financiare të debitorit, mundësia që debitori do të hyjë në bankrotim apo riorganizim financiar, dhe mospagim apo gabimet në pagesa konsiderohen si indikatorë që llogaritë e arkëtueshme tregtare janë dëmtuar.

Borxhet e këqija shlyhen kur identifikohen si të tilla.

3.15 Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme

Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme përfshijnë paratë e gatshme në dorë dhe në bankë. Për qëllime të rrjedhës së parasë paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme paraqesin paratë e gatshme në dorë dhe depozitat e pakufizuara në banka, nëse ka ndonjë.

3.16 Provizionet

Një provizion njihet kur Kompania ka një detyrim të tanishëm si rezultat i një ngjarjeje në të shkuarën dhe është e besueshme që një rrjedhë e burimeve që paraqesin përfitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të paguar një detyrim, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet në lidhje me shumë e obligimit. Provizionet rishikohen gjatë secilës datë të bilancit të gjendjes dhe korrigojnë me qëllim që të reflektojnë vlerësimin më të mirë aktual. Kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material, shuma e provizionit është vlera e tanishme e shpenzimeve të cilat priten të jenë të nevojshme për të paguar obligimin.

3 POLITIKAT E RENDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.17 Njohja e të hyrave

Të hyrat njihen në vlerën reale të tyre të shumës së pranuar apo të pritshme. Te hyrat nga transmisioni i energjisë bazohet në transmisionin e energjisë duke u bazuar në tarifat e caktuara nga ana e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRE).

Te hyrat zvogëlohen në bazë të vlerësimit të humbjeve në linja.

3.18 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje me shfrytëzimin e shërbimit ose në datën e origjinës së tyre.

3.19 Zotimet dhe kontingjentet

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Një detyrim kontingjent shpaloset në të gjitha rastet përveç rasteve kur mundësia e rrjedhës së burimeve që paraqesin përfitime ekonomike është e largët. Një aset kontingjent nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundur. Shuma e një humbjeje kontingjente njihet si provizion nëse është e besueshme që ngjarjet në të ardhmen do të konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri më datën e bilancit të gjendjes dhe se mund të bëhen një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes që pason.

3.20 Gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të Kompanisë

Në aplikimin e politikave të kontabilitetit, të cilat janë të përshkruara më lartë, nga menaxhmenti kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumat e bartura të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk janë lehtësisht të qarta nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorët tjerë të cilët konsiderohen të jenë relevantë. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshëm nga këto vlerësime.

3.21 Thyerja e aseteve dhe obligimeve

Aseti dhe obligimi financiar thyhet dhe vlera neto e raportuar në bilancin e gjendjes, nëse Kompania ka ndonjë të drejtë ligjore të thyej transaksionet dhe gjithashtu ka synim të rregulloj në baza neto dhe të realizoj asetin dhe paguaj obligimin në të njëjtën kohë.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.
 Shënimet për pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

4 PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Toka (në Euro 000)	Objektet (në Euro 000)	Impiantet dhe makineria (në Euro 000)	Automjetet dhe pajisjet tjera (në Euro 000)	Asetet në ndërtim* (në Euro 000)	Total (në Euro 000)
Kostoja						
Më 1 Janar 2010	1,818	30,560	36,847	1,361	12,532	83,118
Shtesat	65	4,242	4,950	123	9,093	18,473
Transferet	-	58	4,486	10	(4,554)	-
Shlyerjet	-	-	(29)	-	-	(29)
Më 31 Dhjetor 2010	1,883	34,860	46,254	1,494	17,071	101,562
Shtesat	234	5,335	4,317	1,513	218	11,617
Transferet	-	1,103	12,780	-	(13,883)	-
Shlyerjet	-	-	-	(2)	-	(2)
Më 31 Dhjetor 2011	2,117	41,298	63,351	3,005	3,406	113,177
Zhvlerësimi i akumuluar						
Më 1 Janar 2010	-	3,719	3,723	481	-	7,923
Shtesat gjatë vitit	-	1,403	3,133	333	-	4,869
Zhvlerësimi i shlyer	-	-	(21)	-	-	(21)
Më 31 Dhjetor 2010	-	5,122	6,835	814	-	12,771
Shtesat gjatë vitit	-	2,297	3,761	246	-	6,304
Më 31 Dhjetor 2011	-	7,419	10,596	1,060	-	19,075
Vlera neto						
Më 31 Dhjetor 2011	2,117	33,879	52,755	1,945	3,406	94,102
Më 31 Dhjetor 2010	1,883	29,738	39,419	680	17,071	88,791

E përfshirë në vlerën totale të mjeteve themelore në vlerë prej Euro 16,109 mijë (2010: Euro 14,196 mijë), janë mjetet e impianteve dhe pajisjeve të vilat janë pranuar nga grantet. Vlera e zhvlerësimit për vitin në Euro EUR 3,276 mijë (2010: Euro 1,787 mijë) është liruar nga të hyrat e shtyra të njohura si të hyrat nga grantet në pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse (shih shënimin 12)

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.
 Shënimet për pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

5 ASETET E PAPERKSHME

	Softueri (në Euro 000)
Kostoja	
Bilanci më 1 Janar 2010	76
Shtesat gjatë vitit	7
Bilanci më 31 Dhjetor 2010	83
Shtesat gjatë vitit	1,466
Bilanci më 31 Dhjetor 2011	1,549
Amortizimi i akumuluar	
Bilanci më 1 Janar 2010	30
Amortizimi për vitin	17
Bilanci më 31 Dhjetor 2010	47
Amortizimi për vitin	45
Bilanci më 31 Dhjetor 2011	92
Neto vlera më 31 Dhjetor 2011	1,457
Neto vlera më 31 Dhjetor 2010	36

6 INVENTARI, PJESE REZERVË DHE MJETET TJERA

	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Materialet dhe konsumuese	305	297
Derivatet dhe lubrifikantët	23	27
Pjesë rezervë	1,494	704
Të tjera	42	66
Provizioni për lëvizje të ngadalshme të inventarit	(210)	(186)
	1,654	908

7 LLOGARIT E ARKËTUESHME

	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Llogarit e arkëtueshme KEK Sh.a.	10,646	10,447
TVSH e arkëtueshme	2,774	1,891
Provizioni për llogaritë e arkëtueshme	(5,830)	(3,057)
	7,590	9,281

Të përfshira në provizionet për llogaritë e arkëtueshme janë edhe Euro 383 mijë të cilat nuk janë të regjistruara si shpenzime të provizionit për llogarit e arkëtueshme.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.
 Shënimet për pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

8 TË ARKËTUESHMET TJERA

	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Avance furnitorëve	3,015	6,887
Të tjera	176	109
	<u>3,191</u>	<u>6,996</u>

9 PARAJA NË DORË DHE NË BANKA

	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Paraja në dorë	1	1
Paraja në banka dhe në llogarit rrjedhëse	18,604	14,849
	<u>18,605</u>	<u>14,850</u>

Llogarit rrjedhëse në banka kanë përqindje të interesit prej 2.6% deri 2.8% për vit (2010 2.6% të 2.8% për vit)

10 KAPITALI AKSIONAR

	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Kapitali aksionar i regjistruar	25	25
	<u>25</u>	<u>25</u>

KOSTT Holding Sh.a. një shoqëri aksionare, zotëron 100 % të kapitalit aksionar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010, zotëruesi final i KOSTT Sh.a. është Qeveria e Republikës së Kosovës.

11 PRIMI I AKSIONEVE

	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
<i>Tjera nga paraja</i>		
Prona, impiantet dhe pajisjet	27,839	27,839
Inventari	493	493
Toka e pranuar nga KEK në Podujevë	15	15
	<u>28,347</u>	<u>28,347</u>

Në datën efektive të inkuorporimit me 1 Qershor 2006 KEK-u ka transferuar tek KOSTT Sh.a. asete ne vlerën e tyre kontabël sipas marrëveshjes ndërmjet KEK Sh.a. dhe KOSTT Sh.a..

12 GRANTET E SHTYRA

Lëvizja gjatë vitit

Më poshtë është tabela përmbledhëse e lëvizjes së granteve të shtyra nga 1 Janari deri 31 Dhjetor 2011:

	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Më 1 Janar	69,392	57,362
<u>Shtesat:</u>		
Grantet e pranuar gjatë vitit	9,298	14,019
<u>Minus:</u>		
Lirimet në të hyrat e shtyra (shih tabelën më poshtë)	(3,276)	(1,828)
Paraja e kthyer	-	(161)
	<u>75,414</u>	<u>69,392</u>

Më poshtë është analiza e lirimit të granteve, të regjistruara për fund vitin 31 Dhjetor 2011:

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Zhvlërimi i impianteve dhe pajisjeve	3,108	1,787
Amortizimi i softuerit	-	3
Inventari	168	38
	<u>3,276</u>	<u>1,828</u>

13 LLOGARIT E PAGUESHME DHE TË TJERA

	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
<i>Furnitorët e huaj</i>		
-Elektroprivreda Sërbije - EPS	3,177	3,177
-Elektromreza Sërbije - EMS	1,038	1,038
-Furnitor tjerë	743	1,624
<i>Furnitorët - Lokal</i>	-	-
Korporata Energjetike e Kosovës - KEK Sh.a.	1,574	1,885
Shpenzimet akruale	198	190
Tatimet dhe pensionet e pagueshme	56	52
Tatimi në fitim i pagueshëm	-	157
Tatimi i shtyrë	137	185
Të tjera	522	705
	<u>7,445</u>	<u>9,013</u>

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.
 Shënimet për pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

14 TË HYRAT

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Te hyrat nga transmisioni i energjisë - KEK Sh.a.	14,706	20,076
	14,706	20,076

15 TË HYRAT TJERA OPERATIVE

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Të hyrat nga grantet	3,276	2,055
Të hyrat nga shitja e skrapit	241	278
Të tjera	26	15
	3,543	2,348

16 SHPENZIMET E STAFIT

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Pagat e stafit	2,688	2,522
Kontributet pensionale	143	126
Pagat e punëtorëve me kontratë	114	88
	2,945	2,736

17 RIPARIMET DHE MIRËMBAJTJA

Riparimet dhe mirëmbajtja në vlerë prej Euro 744 mijë (2010: Euro 752 mijë) lidhet me riparimet dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të rrjetit të transmisionit.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.a.
 Shënimet për pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

18 SHPENZIMET TJERA OPERATIVE

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2011	Për fund vitin 31 Dhjetor 2010
	(në Euro 000)	(në Euro 000)
Derivatet dhe lubrifikantet	222	190
Shpenzimet e udhëtimeve	153	207
Shpenzimet e sigurimit	148	205
Materialit i zyrës dhe inventari i imët	128	141
Komunalit	117	116
Shërbimet e këshillimit dhe të tjera	112	208
Shpenzimet e marketingut dhe reprezentacionit	89	114
Tatimi në prone dhe taksat tjera	63	47
Shpenzime mjekësore	46	45
Sigurimi i makinave	12	12
Shlyerja e aseteve fikse	4	8
Komisionet bankare	4	6
Shpenzimet e anëtarësimit	1	1
Shpenzimet e trajnimit	-	86
Shpenzimet tjera	234	128
	1,333	1,514

19 TATIMET

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Shpenzimet e tatimit të vitit	194	657
Tatimi i shtyrë (të hyrat)/shpenzimi	(48)	16
Shpenzimi i tatimi	146	673

Me poshtë është në detaje e shpjeguar kalkulimi i tatimit në fitim i vitit:

	Për fund vitin 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Për fund vitin 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Fitimi para tatimit	1,429	4,141
Korrigjim për shpenzime të palejueshme për qëllime tatimi:		
Shpenzime të palejueshme	28	2,756
Zhvlerësimi (palejueshëm)/lejuar sipas rregullave të tatimeve	481	(166)
Fitimi i korrigjuar për qëllime tatimi për vitin	1,938	6,731
Tatimi në fitim në 10%	194	673

19 TATIMET (VAZHDIM)

Nga 1 Janari 2010 shkalla e tatimit në të ardhurat e korporatave është 10% në pajtim me rregullat e taksave në Kosovë në fuqi, Ligji Nr. 03/L-162 “Mbi tatimin e të ardhurave nga Korporatat”.

Tatim në fitim i pagueshëm:

	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Tatimi në fitim i pagueshëm	-	157
Lëvizja në diferencat e përkohshme	137	185
	<u>137</u>	<u>342</u>

Tatimi i shtyrë është njohur si në vijim:

	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000)	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000)
Hapja në tatimin e shtyrë	185	169
Lëvizja në diferencat e përkohshme	(48)	16
Tatimi i shtyrë	<u>137</u>	<u>185</u>

20 TRANSAKSIONET ME PALËT E NDËRLIDHURA

Palët e ndërlidhura përbëhen nga kompania mëmë, ndërmarrjet e përbashkëta, kompanitë tjera të ndërlidhura, drejtorët e Kompanisë dhe menaxhmenti kryesor. Kompania në kushtet normale të biznesit bënë transaksionet me palët e ndryshme të ndërlidhura.

Kompensimi i menaxhmentit kryesor

	2011 (në Euro 000)	2010 (në Euro 000)
Pagat dhe benefitet afatshkurtra	452	468
Bordi menaxhues	89	73

Grantet nga palët e ndërlidhura

	2011 (në Euro 000)	2010 (në Euro 000)
Ministria e financave	75,413	69,392

Të gjitha transaksionet me palët e ndërlidhura janë bërë në kushtet tregtare në vlerën e tregut.

21 ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

Çështjet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2011, rastet gjyqësore të iniciuara kundër Kompanisë janë në shumë prej Euro 115 (2010:310) mijë. Deri në datën e bilancit të gjendjes nuk është bërë ndonjë provizionim, meqë këshillimi profesional tregon se nuk ka mundësi që të paraqitet ndonjë humbje e madhe. Gjithashtu, veprime të ndryshme juridike mund të pohohen në të ardhmen kundër Kompanisë nga çështjet gjyqësore gjatë kursit të rregullt të afarizmit. Rreziqet e ndërlidhura janë analizuar në bazë të mundësisë së paraqitjes. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mund të matet me precizitet, menaxhmenti i Kompanisë beson se nuk do të paraqiten detyrime materiale.

Zotimet

Gjatë 2011, Kompania ka nënshkruar marrëveshje me kompani për financim të shpenzimeve kapitale në shumë prej Euro 4,844 mijë. Shuma prej Euro 993 mijë është realizuar gjatë vitit 2011, dhe plotësimi i pjesës së mbetur prej Euro 3,851 mijë pritet të realizohet gjatë vitit 2012.

Për zotimet që kanë të bëjnë me grantet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, të cilat janë kontraktuar përgjatë viteve të mëhershme, të realizuara gjatë vitit 2011 janë në shumë prej Euro 7,385 mijë dhe pjesa prej Euro 3,491 mijë mbetet për vitet në vijim.

Detyrimet afatgjate

Çështje të ndryshme ligjore mund të paraqiten në të ardhmen kundër Kompanisë duke u bazuar në detyrime afatgjate të mundshme të cilat kanë ekzistuar para kohës së vendosjes së administratës së UNMIK-ut në territorin e Kosovës. Në datën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, rezultati i këtyre çështjeve nuk mund të caktohet me saktësi dhe nuk është bërë provizion në lidhje me detyrime të tilla afatgjate.

Detyrimet e tatimeve

Librat e Kompanisë dhe regjistrimet nuk ishin audituar nga autoriteti i tatimeve për vitin 2011. Prandaj, detyrimet tatimore të Kompanisë mund të mos konsiderohen si të përfunduara. Një provizion për ndëshkime dhe tatime shtesë, nëse do kishte ndonjë, që mund të vjen, gjatë kësaj faze, nuk mund të përcaktohet me ndonjë saktësi të arsyeshme.

22 MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

22.1 Rreziku kreditor

Rreziku kreditor paraqet humbjen e cila do të ishte njohur në datën e raportimit, nëse pala tjetër nuk arrin ti kryej obligimet e kontraktuara. Instrumentet financiare të cilat mund ta nënshtrojnë Kompaninë në rrezikun kredit janë kërkesat nga KEK SH.A.

22.2 Rreziku i tregut

Kompania nuk ka hy në ndonjë transaksion mbrojtëse për të mbuluar ekspozimin ndaj lëvizjeve të çmimeve që vijnë nga operacionet e saja.

22.3 Rreziku i normave të interesit

Rreziku i interesit vjen nga mundësia që ndryshimet në normat e interesit të afektojnë vlerën e instrumenteve financiare. Kompania nuk hyn në kontrata të këmbimit me norma interesi meqë nuk ka asnjë kredi nga e cila përfiton interes.

22.4 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit reflekton paaftësinë e Kompanisë për të siguruar fonde për të përmbushur angazhimet e saj. Menaxhmenti monitoron drejtpërdrejtë likuiditetin e Kompanisë dhe pozitën e saj të rrjedhës së parasë. Kjo përfshin mirëmbajtjen e indikatorëve të likuiditetit të bilancit të gjendjes, koncentrimin e debitorëve dhe kreditorëve si në terma të miksit të përgjithshëm të financimit si dhe shmangien nga mbështetja e tepërt në konsumatorë të mëdhenj individual.

22.5 Rreziku nga kursi valutor i këmbimit

Rreziku nga kursi i këmbimit shfaqet kryesisht kur ekzistojnë llogari të arkëtueshme ose të pagueshme për shkak të transaksioneve me ndërmarrje të huaja. Megjithatë, Kompania nuk është e ekspozuar ndaj ndonjë rreziku domethënës nga kursi i këmbimit për shkak se shumica e transaksioneve kryhen në Euro.

22.6 Vlera reale e instrumenteve financiare

Vlera reale është shuma për të cilën një aset mund të këmbëhet apo një detyrim mund të shlyhen, ndërmjet palëve me vullnet dhe të mirinformuara në një transaksion duar lirë.

Menaxhmenti beson që vlera e bartur e të gjitha aseteve financiare dhe detyrimeve e reflektuar në pasqyrat financiare është e përafërt me vlerën e tyre reale.

23 NGJARJET PASUESE

Më 3 Gusht 2011, Qeveria e Kosovës ka lëshuar një vendim, për transferimin e aseteve prej 110 KV nga KEK Sh.a. në KOSTT Sh.a.

Sipas atij vendimi, më 29 Shkurt 2012, KOSTT Sh.a., KEK sh.a. dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik kanë nënshkruar marrëveshjen për ekzekutimin e këtij transferi.

Rezultati i këtij procesi është si në vijim:

Efektive më 1 Prill 2012, asetet të cilat do të transferohen nga KEK Sh.a. në KOSTT Sh.a. janë në shumën prej Euro 16,778 mijë (vlera neto në libra Euro 11,084 mijë) në formë të mjeteve themelore si dhe 139 punëtorë. Të gjitha këto më herët kanë qenë pronë e KEK Sh.a.